# KUJDES!

- Mos harroni të kodoni grupin (A ose B) në fletë-përgjigjen e provimit. **Fletë-përgjigjet me grupin e pakoduar nuk vlerësohen.**
- Çdo pyetje ka vetëm një përgjigje të saktë. Nëse një pyetjeje i jepni dy përgjigje atëherë ajo pyetje do të vlerësohet si e gabuar.
- Përgjigja do të kodohet me laps. Në të kundërt kompjuteri nuk do ta lexojë.
- Përgjigjen e pyetjes do ta kodoni vetëm brenda rrethit siç është vepruar në shembullin e poshtëshënuar

  Saktë Ⓐ Ⓑ ● Ⓓ    Gabim Ⓐ Ⓑ Ⓒ Ⓓ

- Bëni kujdes për të mos dalë jashtë rrethit kur të kodoni përgjigjen.
- Mos bëni asnjë veprim mbi fletë përgjigjen e provimit si shkarravitje, rrudhosje etj.
- Mos iu përgjigjni pyetjeve për të cilat nuk jeni të sigurtë. **Kujdes! 3 përgjigje gabim fshijnë një të saktë.**
- Mos qëndroni shumë tek pyetjet që nuk zgjidhni dot, sepse koha mund të mos ju mjaftojë për t'iu përgjigjur pyetjeve të tjera.
- Koha e provimit është **150 minuta**. Shfrytëzoni deri në fund kohën e provimit. Në qoftë se ju tepron kohë, bëjini dhe një kontroll testit.
- Përgjigjet e pyetjeve që ndodhen në këtë libërth, do të kodohen në fletë-përgjigje në pjesën ku shkruan "PERGJIGJET".
- Në provim **ndalohet** mbajtja ose përdorimi i celularit dhe makinës llogaritëse.
- Rezultati i provimit bazohet vetëm në fletë-përgjigje.
- Libërthi i pyetjeve dorëzohet bashkë me fletë-përgjigjen dhe nuk kërkohet marrja e tij.

*Suksese!*

## 1.

Sa është rezultati i shprehjes
$\frac{-3\cdot 6\cdot(-5)}{-9}$?

A) 10 B) -10
C) 20 D) -20

## 2.

Sa është rezultati i shprehjes
$\sqrt{0.64}+\sqrt{0.04}-0.5$?

A) 0.3 B) 0.4
C) 0.5 D) 0.6

## 3.

Sa është rezultati i shprehjes $\frac{(2)^{2005}}{(2)^{2002}}-4$?

A) 2 B) 4
C) 6 D) 8

## 4.

Sa është shumëfishi më i vogël i përbashkët i 8, 12, 16?

A) 4 B) 24
C) 36 D) 48

## 5.

Sa është vlera e shprehjes $x^3 - 2xy$ kur $x = -2$ dhe $y = -3$ ?

A) 4
B) -4
C) 20
D) -20

## 6.

$15.6 - 18.3 = ?$

A) 2.7
B) -2.7
C) 3.3
D) -3.3

## 7.

$y - x = ?$




A) 45°
B) 60°
C) 90°
D) 120°

## 8.




A) 58°
B) 85°
C) 122°
D) 116°

**9.**

Rendisni thyesat e mëposhtme nga më e madhja tek më e vogla.

$$a=\frac{2}{3},\ b=\frac{7}{9},\ c=\frac{5}{6},\ d=\frac{8}{10}$$

A) a,b,c,d B) d,b,c,a
C) c,d,b,a D) c,b,d,a

**10.**

Sa është vlera e x?

$$2(x+3)-5(3+x)=-9$$

A) 0 B) 1
C) 2 D) 3

**11.**

Mesatarja aritmetike e 5 numrave është 6, një numër shtohet dhe mesatarja behët 6,5. Sa është numri i shtuar?

A) 7 B) 8
C) 9 D) 6

**12.**

Cila nga figurat gjeometrike ka më pak drejtëza simetrie?

A) Rrethi
B) Katrori
C) Drejtkëndëshi
D) Trekëndëshi barabrinjës

## 13.

Numri 49998 i rrumbullakosur me përafërsi 10 është:

A) 5000 B) 49990

C) 50000 D) 49000

## 14.

Jepen 2 funksione $f(x)=3x-9$ dhe $g(x)=3-5x$. Sa është $g(-2)-f(5)$?

A) 6 B) 7

C) 8 D) 9

## 15.

Gjeni siperfaqen e trapezit.




A) 38 cm² B) 40 cm²

C) 52 cm² D) 45 cm²

## 16.

Genti do ta shlyejë kredinë e marrë në bankë prej 5 740 000 lekë për 4 vjet në raportin 1:1:2:3. Gjej sa lekë do paguajë vitin e fundit ai?

A) 2 460 000

B) 1 640 000

C) 820 000

D) 410 000

## 17.

Gjeni vlerën e x.




A) 40°   B) 50°
C) 60°   D) 70

## 18.

Në tabelën e mëposhtme është paraqitur antarësia e një klubi të rinjsh.

| | Më të rinj se 13 vjeç | 13 vjeç e më tepër |
|---|---|---|
| Vajza | 20 | 15 |
| Djem | 18 | 22 |

Një person është zgjedhur rastësisht. Cili është probabiliteti që ai të jetë vajzë mbi 13 vjec?

A) $\frac{20}{45}$   B) $\frac{22}{45}$

C) $\frac{1}{3}$   D) $\frac{1}{5}$

## 19.

Shuma e tre numrave është 63. Numri i parë është sa dyfishi i numrit të dytë dhe numri i tretë është sa trefishi i numrit të parë. Sa është numri i parë?

A) 7   B) 10
C) 12   D) 14

## 20.

Cili nga numrat e mëposhtëm bën pjesë në zgjidhjen e inekuacionit $-12 < 8 - 4x < 16$ ?

A) 7   B) -7
C) -1   D) 10

## 21.

Cili prej numrave të mëposhtëm nuk është numër i thjeshtë?

A) 1 B) 2
C) 3 D) 5

## 22.

Katrori është .................... romb.

A) Gjithmonë
B) Asnjëherë
C) Ndonjëherë
D) Asnjë nga alternativat nuk është e saktë.

## 23.

Drejtkëndëshi është .......................... katror.

A) Gjithmonë
B) Asnjëherë
C) Ndonjëherë
D) Asnjë nga alternativat nuk është e saktë.

## 24.

$\frac{5}{6}\cdot\frac{3}{25}=?$

A) $\frac{2}{25}$ B) $\frac{1}{5}$

C) 0.1 D) 0.01

## 25.

Hidhen dy zare të ndryshëm njëherësh, sa është probabiliteti që shuma e tyre të jetë më e madhe se 10?

A) $\frac{1}{12}$ B) $\frac{1}{6}$

C) $\frac{1}{3}$ D) $\frac{1}{2}$

## 26.

Një produkt me 20% ulje e ka çmimin $64. Sa ka qenë çmimi fillestar i produktit?

A) $60 B) $70

C) $75 D) $80

## 27.

Agroni bleu 8 fletore për 1000 lekë. Sa ka kushtuar një fletore?

A) 100 lekë

B) 120 lekë

C) 125 lekë

D) 130 lekë.

## 28.

$82 \div 0.01$

A) 0.0082 B) 0.082

C) 820 D) 8200

## 29.

Një makinë përshkon 12 km për 15 min, sa është shpejtësia e makinës në km/orë?

A) 24
B) 36
C) 48
D) 12

## 30.

$$\frac{5\times 7}{20}-1\frac{3}{4}=?$$

A) 0
B) $\frac{1}{5}$
C) 1
D) $\frac{3}{20}$

## 31.

Cili numër zëvendëson pikëpyetjen në vargun e numrave të mëposhtëm?

0, 19, 38, 57, ?, 95

A) 75 B) 76
C) 85 D) 86

## 32.

Sa është vlera e pikëpyetjes në figurën e mëposhtme?




A) 6 B) 3
C) 4 D) 5

## 33.

Cila nga figurat e mëposhtme është ndryshe nga të tjerat?

A)


B)


C)


D)


## 34.

Sa është vlera e pikëpyetjes në figurën e mëposhtme?




A) 4 B) 4.5
C) 6 D) 6.5

## 35.

Cili katror mungon?



A) 

B) 

C) 

D) 

## 36.

Cili numër zëvendëson pikëpyetjen?




A) 7
B) 10
C) 12
D) 14

## 37.

Cila nga figurat e mëposhtme zëvendëson pikpyetjen?



A) 

B) 

C) 

D) 

## 38.

Cili numër zëvendëson pikëpyetjen?

| | | |
|---|---|---|
| 16 | ? | 32 |
| 40 | 48 | 56 |

A) 20
B) 22
C) 24
D) 26

## 39.

Cili numër zëvendëson pikëpyetjen?

**16 32 2**
**12 36 3**
**8 ? 4**

A) 30 B) 24
C) 16 D) 32

## 40.

Cili numër zëvendëson pikëpyetjen?




A) 11 B) 12
C) 13 D) 14

## 41.

Tre drejtkëndësha me të njëjtën lartësi janë dhënë si më poshtë. Brenda drejtkëndëshave është dhënë sipërfaqja e tyre në cm². Sa është gjatësia e [CD]?




A) 7 cm B) 7.5 cm
C) 8 cm D) 8.2 cm

## 42.

Sa numra katërshifror kanë vetinë që shifrat e tyre, nga e majta në të djathtë, janë të njëpasnjëshme dhe janë në rendin rritës?

A) 4 B) 5
C) 6 D) 7

## 43.

Një fjalëkalim përbëhet nga katër shkronjat A,B,C,D.

- *A nuk është as e para e as e fundit.*
- *B nuk është e fundit.*
- *C është e fundit.*
- *D vjen para shkronjës A.*

Gjeni fjalëkalimn duke përdorur 4 pohimet.

A) *BACD*
B) *DABC*
C) *CABD*
D) *BADC*

## 44.

Në një lëndinë të vogël numri i luleve dyfishohet çdo ditë. Nëse fillohet me një lule lëndina mbushet me lule për 120 ditë. Nëse do të fillonte me 4 lule për sa ditë do të mbushej lëndina me lule?

A) 15 B) 30
C) 118 D) 119

## 45.

Cila figurë zëvendëson pikpyetjen?



A)

B)


C)

D)


## 46.

Cila alternativë e plotëson vargun e mëposhtëm?

DO, MI, SO, .....

A) RE B) FA
C) LA D) SI

## 47.

Cila figurë zëvendëson pikpyetjen?



A) 
B) 
C) 
D) 

## 48.

Sa trekëndesha ka në figurë?



A) 9
B) 13
C) 15
D) 17

## 49.

Cila figurë zëvendëson pikpyetjen?



A) 
B) 
C) 
D) 

## 50.

Sa është gjysma e 5 plus 5?

A) 5
B) 7.5
C) 10
D) 7

## 51.

***"Është një kallëzim popullor për një dukuri, ngjarje ose personalitet që mund të ketë bazë të vërtetë, por është pasuruar me elemente fanastike."*:**

A) Miti
B) Përralla
C) Legjenda
D) Poema epike

## 52.

**Pjesa *"Kush e solli Doruntinën"* i përket llojit letrar të:**

A) Romanit
B) Novelës
C) Baladës
D) Përrallës

## 53.

**Romani *"Djemtë e Rrugës Pal"* është shkruar nga:**

A) Ismail Kadare
B) Ferenc Molnar
C) Franc Kafka
D) Dino Buxati

## 54.

***Shndërrimin fizik e psikologjik të individit, në situata të paqarta dyzimi e dilemash* e gjejmë në fragmentin letrar:**

A) "Një kryqëzim"
B) "Kolombreja"
C) "Djemtë e Rrugës Pal"
D) "Nata e Ustikës"

## 55.

***Personazhi i Tanushës* i përket pjesës:**

A) "Arnaut Osmani"
B) "Kthimi i Odisesë"
C) "Martesa me Orën-zonjë"
D) "Martesa e Halilit"

## 56.

**Mesazhi që *"Nëse njeriu e cënon dhe e dhunon natyrën, natyra do t'i përgjigjet ashpër."*, përcillet përmes pjesës:**

A) "Pyetja e fundit"
B) "Nata e Ustikës"
C) "Lumi i madh"
D) "Siç më thotë nënua plakë"

## 57.

**Poezinë *"Kinemaja e vjetër"* e ka shkruar:**

A) Ismail Kadare
B) Martin Camaj
C) Lasgush Poradeci
D) Migjeni

## 58.

**Në vargun: "*N'ajri ndihen klithmat e natës që ra…*", kemi figurat letrare të:**

A) krahasimit dhe epitetit
B) metaforës dhe similitudës
C) metaforës dhe shpirtëzimit
D) metaforës dhe epitetit

## 59.

**Është cilësuar nga kritika si shkrimtar i Brezit të humbur**:

A) Ismail Kadare
B) Petro Marko
C) Mitrush Kuteli
D) Musine Kokalari

## 60.

**Gërshetoi më së miri elementët magjike të përrallave e legjendave me elementët e realitetit njerëzor, në veprën e tij:**

A) Isak Asimov
B) Franc Kafka
C) Dino Buxati
D) Ferenc Molnar

## 61.

**Kuptimi i figurshëm që krijohet në bazë të zëvendësimit quhet:**

A) metaforë
B) metonimi
C) epitet
D) krahasim

## 62.

**Tema prej së cilës formohet drejtpërdrejt një fjalë e re është:**

A) rrënja e fjalës
B) tema e fjalës
C) tema fjalëformuese
D) parashtesa dhe prapashtesa

## 63.

**Dalloni në cilin rast fjala *“ndaj”* është përdorur si lidhëz:**

A) Po përpiqem të ndaj legjendën prej reales.
B) Nga qoshja ku isha ulur, kisha përparësi ndaj të tjerëve.
C) Kishim mbërritur në çastin e fundit, ndaj ishim ulur në një kënd të sallës.
D) Duhet të ndaj tekstet letrare nga ato joletrare.

## 64.

**Kryefjala nuk shprehet me:**

A) emër
B) mbiemër
C) përemër
D) grup emëror

## 65.

**Në cilën fjali kemi përemër lidhor:**

A) Dihet që do të vijnë të gjithë.
B) Veproi në atë mënyrë, që të bindte shokët.
C) Shoku që takoi, ishte dhe miku im.
D) Që nga ajo ditë, nuk u panë më.

## 66.

**Pjesëza *“u”* është e formës joveprore, mënyra habitore, në fjalinë:**

A) Po u kërkoja shokëve që të vinin dhe ata me ne.
B) U habita nga ajo çka dëgjova.
C) U rritsh me nënë e babë!
D) U bëka puna dhe kështu!

## 67.

**Në fjalinë: *“E veshi vajzën e vogël bukur bukur dhe u nis për në festë.”*, ndajfolja është në shkallën:**

A) Pohore
B) Krahasore
C) Krahasore e barazisë
D) Sipërore

## 68.

**Ka kallëzues foljor të përbërë në fjalinë:**

A) Ishte bërë gati shpejt dhe ishte nisur pa gdhirë.
B) Kishte nisur të zbardhte më shpejt tani.
C) Ishte e mërzitur, por nuk e dha veten.
D) Kishte filluar leximin e romanit të ri, por shpejt e la mënjanë.

## 69.

**Në fjalinë: *"Rrezet e diellit të mëngjesit përflaknin majat e maleve."*, fjalët e nënvizuara kryejnë funksionin e:**

A) kundrinorit të drejtë
B) kryefjalës
C) përcaktorit me përshtatje
D) përcaktorit me drejtim

## 70.

**Mbiemri në fjalinë *"Kishte kaluar një nga ditët më të gëzuara të jetës së tij."*, është në rasën:**

A) gjinore
B) dhanore
C) emërore
D) kallëzore